

AKT THEMELIMI DHE STATUSI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
Vaeku Studio

Sot date 05.01.2024, ne Tirane, une themeluesi I vetem **Urim Hoxha**, i datelindjes 05.02.1982, lindur ne Peshkopi, madhor me zotesi te plote per te vepruar, me gjendje civile martuar, me shtetesi shqiptare, me nr personal ID: I20205172U, ne baze te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", Ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", themeloj shoqerine tregetare me pergjegjesi te kufizuar me emrin: "**Vaeku Studio**", si me poshte:

Neni 1

EMERIMI I SHOQERISE

Emertimi i shoqerise eshte: "**Vaeku Studio**"

Neni 2

Shoqeria krijohet dhe ushtron veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe veçanerisht Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per Tregetaret dhe Shoqerite Tregetare", Ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", aktet e tjera ligjore qe do te jene ne fuqi gjate veprimtarise se shoqerise si dhe dispozitat e statutit te shoqerise .

Neni 3

Shoqeria "**Vaeku Studio**" eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar me ortak te vetem **Urim Hoxha** i cili nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise tregetare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqerise deri ne pjesen e pa shlyer te kontributeve te nenshkruara . Kontributet e ortakut perbejne kapitalin e regjistruar te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar.

Neni 4

Selia e shoqerise eshte:

Rruga Ndre Mjeda, Kompleksi Magnet, Nd. 10, Njesia 8

Neni 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

Shoqeria "**Vaeku Studio**" ka per objekt kryesor te veprimtarise se saj:

Studimi dhe hartimi i projekteve të zbatimit në fushën e Arkitekturës; Inxhinierisë Civile, Mekanike, Elektrike dhe Hidroteknike; Hartimi i projekteve të Mbrojtjes ndaj Zjarrit dhe Shpëtimin (MNZ); Mbikqyrja dhe Kolaudimi i Punimeve te ndertimit.



Neni 6

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është me afat të pa kufizuar, duke filluar ky afat nga data e marrjes së certifikatës së regjistrimit në QKB, për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

Me vendim të asamblesë së ortakeve (¾) ortakeve, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë mund të ndryshojë, dhe ky vendim i dërgohet menjëherë për depozitim Qendres Kombëtare të Biznesit për të bërë shenimet e nevojshme në Regjistrin e Shoqërive Tregtare.

Neni 7

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj, gjithashtu ajo mund të hapë, filiale, dege, ose perfaqësi të rrethë të ndryshme të republikës së Shqipërisë, apo në shtete të tjera, në përputhje me legjislacionin e vendeve përkatëse.

Neni 8

KAPITALI DHE PJESET

Kapitali themelor fillestar i shoqërisë është 100.000 leke (njëqind mijë), i cili përben 1 (një) kuotë.

Kapitali themeltar i shoqërisë mund të zmadhohet, zvogëlohet me vendim të marrë prej ¾ nga Asambleja e ortakeve.

Neni 9

KONTRIBUTET

Kapitali themeltar i shoqërisë “**Vaeku Studio**” zotërohet nga ortakët i vetëm i shoqërisë **Urim Hoxha**, në masën 100% dhe i përket teresisht atij.

Vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë është shlyer plotësisht me kontributin e ortakut të vetëm.

Shoqëria tregtare mund të leshojë një certifikatë për të vertetuar zotërimin e kuotës së kapitalit. Kjo certifikatë leshohet në emër të personit apo të personave që zotërojnë kuotën dhe nuk përben leter me vlerë.

Për nevojat e punës dhe të ushtrimit të aktivitetit të saj shoqëria mund të çelë llogari në çdo bankë të njohur me ligj, qoftë kjo private ose shtetërore.

Neni 10

ORGANET E SHOQËRISË

(asambleja e përgjithshme, të drejtat dhe detyrimet)

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a- Percaktimin e politikave tregetare te shoqerise;
 - b- ndryshimin e statutit;
 - c- emerimin e shkarkimin e administratoreve;
 - d- emerimin e shkarkimin e likujdvesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar
 - e- percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c", "ç" te kesaj pike;
 - f- mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregetare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - g- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - h- zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
 - i- pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre;
 - j- perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera nga administratoret;
 - k- riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - l- miratimin e regullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese ;
 - m- ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e pergjitheshme mer vendime per ceshtjet e percaktuara ne shkronjat "e" dhe "e" te pikes 1 , pas ,marjes dhe shqyrtimit te dokumentave perkatese.
3. Nese shoqeria zoterohet nga nje ortak, te drejtat dhe detyrimet e asamblese ushtrohen nga ortaku i vetem. Te gjitha vendimet e mara nga ortaku i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve , te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen . Duhet regjistruar ne vecanti , por pa u kufizuar ne te vendimet per;
- a- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - b- shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve ;
 - c- investime;
 - d- vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e pa regjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pa vlefeshme. Shoqeria nuk mund ti kundrejtoje pavlefshmerine te tretit , qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur djene per pavlefshmerine, apo ne baze te rethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur djene per te.

Neni 11

ADMINISTRATORET

Emerimi, shkarkimi, te drejtat dhe detyrimet

Asambleja e pergjitheshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit nuk mund te jete me i gjate se 5 vjet , me te drejte riperseritje. Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren kombetare te regjistrimit.

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen te;



- a- kryejne te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregetare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregetare , te vendosura nga asambleja e pergjitheshme;
- b- perfaqesojne shoqerine tregetare ;
- c- kujdesen per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d- pergatisin dhe nenshkruajne bilancin vjetor , bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve , i paraqesin keto documenta perpara asamblese per miratim;
- e- krijojne nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- f- kryejne regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise , sic parashikohet ne ligjin per Qendren kombetare te Regjistrimit;
- g- raportojne perpara asamblese se pergjitheshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregetare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregetare;
- h- kryejne detyra te tjera te percaktuara ne statut e ligj

Administratoret jane te detyruar te therasin asamblene e pergjitheshme.

Ne rastet e emerimit te me shume se nje administrator ata e administrojne bashkarisht shoqerine.

Asambleja e pergjitheshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakoneshme . Statuti apo mareveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo kufizojne kete te drejte.

Pervec dispozitave te pergjitheshme te detyrimit te besnikerise , sipas neneve 14, 15, 17, 18, te Ligjit 9901 dt 14.04.2008 “Per tregetaret dhe shoqerite tregetare“ Administratoret detyrohen;

- a- te kryejne detyrat e tyre te percaktuara ne ligj ose ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi ;
- b- te ushtrojne kopetencat qe u njihen ne ligj ose ne statut vetem per arritjen e qellimeve dhe objektivave te shoqerise ;
- c- te vleresojne me pergjegjesi ceshtjet , per te cilat meret vendim ;
- d- te parandalojne dhe menjanojne rastet e konfliktit , prezent apo te mundshem , te interesave personale me ato te shoqerise
- e- te garantojne miratimin e mareveshjeve sipas dispozitave te pikes 3 , neni 13 i ligjit “ Per tregetaret dhe shoqerite tregetare “
- f- te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe kujdesin e nevojshem

Administratoret, gjate kryerjes se detyrave te tyre, pergjigjen ndaj shoqerise per cdo veprim apo mos veprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise tregetare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mos veprimi eshte kryer ne mirebesim.

Nese administratoret veprojne ne kundersizem me detyrat dhe shkelin standartet profesionale jane te detyruar ti demshperblejne shoqerise demet , qe rjedhin nga kryerja e shkeljes , si dhe ti kalojne cdo fitim personal qe ata ose personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te pa rregullta .

Administratoret kane barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te regullt e sipas standarteve te kerkuara .

Ne menyre te vecante , por pa u kufizuar ne to , administratoret jane te detyruar ti demshperblejne shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtrim me dispozitat e ketij ligji, kryejne veprimet e meposhteme;

- a. u kthejne ortakeve kontributet ;
- b. u paguajne ortakeve interesa apo dividente;
- c. u shpendajne aktivet shoqerise;
- d. lejojne qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregetare, kur ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;
- e. japin kredi

Neni 12

EMERTIMI I PARE I ADMINISTRATORIT

Administrator i shoqerise "**Vaeku Studio**" per periudhen 5 vjeçare emerohet **Urim Hoxha**, i cili eshte edhe ortaku i vetem i shoqerise dhe i autorizuar nga shoqeria te perfaqesoje shoqerine ne te gjitha procedurat e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Ky akt themelimi redaktohet ne tre kopje orgjinale dhe nenshkruhet regullisht nga ortaku i vetem i shoqerise "**Vaeku Studio**".

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Ortaku i Vetem

Urim Hoxha

Urim Hoxha 